

GJYKATA KOMUNALE NË DEÇAN**Kryetari i Trupit Gjykses:****Gjyqtari i EULEX-it Riku Jaakkola****10.06.2011****C nr. 275/2009**

Paditësit	Miloš Vukčević, Podgoricë, Mali i Zi; Stevan Vukčević, Podgoricë, Mali i Zi; Jovanka Vukčević, Podgoricë, Mali i Zi; gjithë të përfaqësuar nga avokati Selim Cacaj
I padituri	Lipljan Teodosije Šibalić, Deçan; i përfaqësuar nga avokati Ljubomir Pantović
Rasti	Kompensim i dëmeve, vlera e kontestit 70.000 euro
Shqyrtimi kryesor	më 18, 19 dhe 26 Maj 2011

AKTGJYKIM

Padia është REFUZUAR. Paditësit janë të obliguar që ti paguajnë bashkërisht të paditurit 1.186,50 euro si kompensim për shpenzimet procedurale. Nga ajo shumë 500 euro do të merren nga depozita që paditësit e kanë vënë në gjykatë për shpenzimet e procedues gjyqësore.

ARSYETIMI**Faktet e padiskutueshme**

Ilija Vukčević më 4 janar 1967 bëri një kontratë për shfrytëzimin e një banese me sipërfaqe prej 38,23 m² që gjendet në kuadër të një shtëpie në rrugën Edvard Kardelj (më vonë rruga e Manastirit) Nr. 35. Shtëpia përbëhej nga dy banesa dhe Ilija Vukčević kishte banuar në njërin prej tyre. Në vitin 1993 Ilija Vukčević kishte blerë banesën sipas nenit 16 të Ligjit mbi Banimin (50/92). Sipas kontratës “Blerësi fiton pronësinë mbi të gjitha hapësirat tjera”.

Ilija Vukčević ka vdekur me 12.6.2002. Paditësit kanë fituar pronësinë e pronës në pronësi të Ilija Vukčević përmes trashëgimisë. Jovanka Vukčević është e veja e të ndjerit. Miloš dhe Stevan Vukčević janë bijtë e të ndjerit. Gjykata Komunale në Deçan ka lëshuar një aktvendim mbi ekzaminimin e trashëgimisë më 20.1.2011. Sipas këtij aktvendimi,

secili nga paditësit zotëron një të tretën e patundshmërisë – banesën me sipërfaqe 38,23 m², që gjendet në rrugën “Edvard Kardel” –nr. 35 në Deçan.

Padia

Paditësit kërkojnë që i padituri ka për obligim ti paguaj secilit prej tyre:

- 20.000 euro për dëm material, dhe
- 3.333,33 euro për dhimbje, frikë dhe shqetësim,

Shuma totale prej 70.000 euro përfshirë edhe interesin ligjor pasi që padia është parashtruar më 11.6.2009 deri në pagesën përfundimtare. Për me tepër ata kërkojnë që i padituri gjithashtu duhet ti kompensoj atyre shpenzimet e procedurës gjyqësore, 2.082 euro.

Arsyet për padi

Nga fundi i tetorit të vitit 2007, i padituri ka rrënuar banesat e tyre me sipërfaqe prej 38,23 m², që gjenden në një shtëpi në Rrugën Edvard Kardelj (më vonë Rruga e Manastirit) Nr. 35 dhe gjithashtu objektin ekonomik me sipërfaqe prej 80 m². Edhe shtëpia edhe objekti ekonomik ishin ndërtuar në fillim të viteve 1950-ve. Objekti ekonomik ishte ndërtuar nga Ilija Vukčević. Që të dyja edhe banesa dhe objekti ekonomik ishin të ndërtuara nga guri dhe vlera totale e tyre ishte të paktën 60.000 euro.

Me rrënimin e paligjshëm të këtyre objekteve i pandehuri ka shkaktuar gjithashtu dëme jo materiale ndaj të paditësve. Paditësit janë traumatizuar nga rrënimi i shtëpisë ku ata kishin jetuar qysh nga viti 1966. Ata janë shqetësuar tej mase rreth këtij problemi dhe ata kanë vuajtur nga frika dhe dhembja po ashtu. Kompensimi adekuat për këtë është 3.333,33 euro për secilin prej tyre, shuma totale është 10.000 euro.

Përgjigja

Paditësi ka mohuar padinë. Fillimisht, ekziston një pengesë procedurale për gjykatën që të veproj mbi padinë. Së dyti, i padituri nuk ka rrënuar asnjë objekt në pronësi të Ilija Vukčević. I padituri gjithashtu ka kërkuar që paditësit janë të obliguar që ti kompensojnë atij shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumen prej, 1.550,18 euro.

Arsyet për përgjigjen

Ekziston një pengesë procedurale për gjykatën që të veproj mbi padinë, pasi që paditësit nuk kanë vërtetuar që ata kanë legjitimitet aktiv në këtë rast.

I padituri nuk ka rrënuar nuk ka rrënuar këto objekte. Paditësit nuk kanë vërtetuar që ndonjëherë kishte pasur ndonjë objekt ekonomik në këtë vendndodhje. Edhe po të kishte ekzistuar një shtëpi ekonomike, nuk ka asnjë dëshmi që Ilija Vukčević kishte fituar pronësinë mbi atë. Prandaj paditësit nuk kishin në pronësi asnjë shtëpi ekonomike.

Edhe nën supozimin se padia do të konsiderohej si e justifikueshme kërkesëpasia për dëm material është vlerësuar shumë lartë. Vlera reale e kësaj banese dhe objektit ekonomik të mundshëm nuk është madje as afër 60.000 euro.

Në çfarëdo rrethanash, paditësit nuk gëzojnë të drejtën për çfarëdo lloj kompensimi për dëme jo materiale. Nuk ka asnjë provë për çfarëdo dhembje, frike apo shqetësimi për të cilat kompensimi duhet të bëhet.

Historia Procedurale

Përmes vendimit të gjyqtarit të EULEX-it duke vepruar në bazë të ngarkimit nga Kryetari i Asamblesë së Gjyqtareve të EULEX-it, më 4 nëntor, rasti i është caktuar gjyqtarit të EULEX-it Riku Jaakkola.

Gjykata ka zhvilluar dy seanca paraprake më 23 shkurt 2011 dhe 12 prill 2011. Në seancën më 23 shkurt 2011, gjykata ka lëshuar një aktvendim rreth çështjes nëse paditësit kanë legjitimitet aktiv apo nuk kanë. Sipas atij aktvendimi (shih procesverbalin e seancës paraprake të datës 23 shkurt 2011, faqe 11) paditësit kanë legjitimitet aktiv pasi që aktvendimi i Gjykatës Komunale në Deçan të datës 20 janar 2011, vërteton se paditësit kanë trashëguar banesën në fjalë nga babai i tyre i ndjerë. Secili nga paditësit tani zotërojnë një të tretën e banesës.

Në seancën e datës 23 shkurt, gjykata gjithashtu ka lëshuar një aktvendim me propozimin nga i padituri dhe duke urdhëruar paditësit që të paguajnë shumën prej 500 euro si depozitë për shpenzimet e procedurës gjyqësore (shih procesverbalin e seancës paraprake më 23 shkurt 2011, faqe 16-17).

Gjithashtu mund të vërehet që një procedure penale është duke u zhvilluar kundër të paditurit lidhur me çështjen e njëjtë. Pasi që prokurori i EULEX-it më 10 qershor 2010 vendosi që të tërhiqet nga ndjekja penale, paditësit Miloš, Stevan dhe Jovanka Vukčević më 21 qershor 2010 kanë ngritur një propozim akuzë në Gjykatën Komunale në Deçan kundër të paditurit. Rasti ju është caktuar një gjyqtari të EULEX-it.

Lista e provave

Të gjitha provat e përmendura më poshtë janë paraqitur nga paditësit. Pas titullit të provave, gjendet një përshkrim se çfarë supozohet se ajo provë ka vërtetuar.

Provat me shkrim

Paditësit:

- 1) Kontrata për blerje të banesës 16.3.1993
- paditësit kanë fituar pronësinë mbi banesën dhe shtëpinë ekonomike.

- 2) Kontrata mbi përdorimin e banesës 31.3.1966
- (duhet të lexohet bashkë me provën nr. 1)
- 3) Vendimi nga Komisioni për Kërkesa Banesore dhe Pronësore
KKBP/D/126/2004/C të datës 18.6.2004
- përfaqësuesi ligjor i të paditurit vazhdimisht ka kontestuar ekzistimin e këtij objekti.
- 4) Letra e HPD-së për familjen Vukčević 11.9.2006
- ekzistimi dhe vlera e banesës dhe objektit ekonomik.
- 5) Letra e HPD-së për familjen Vukčević 10.11.2006
- ekzistimi dhe vlera e banesës dhe objektit ekonomik.
- 6) Letra e inspektimit 6.3.2006
- kryeinspektori ishte i pranishëm në ditën kritike, kur objektet ishin rrënuar.
- 7) Njoftimi 7.3.2007
- informata lidhur me banesën se ishte rrënuar më 5.3.2007.
- 8) Njoftimi 7.5.2007
- informata në lidhje me rrënimin e shtëpisë.

Dëgjimi i paditësve

- 1) Miloš Vukčević
- 2) Stevan Vukčević

Dëshmitarët

Paditësit:

- 1) Jashar Hulaj
- ekzistimi i objektit ekonomik; rrënimi i shtëpisë dhe objektit ekonomik.
- Shkelzen Goqi
- ekzistimi i objektit ekonomik; rrënimi i shtëpisë dhe objektit ekonomik.
- 2) Ajne Iberhusaj
- ekzistimi i objektit ekonomik; rrënimi i shtëpisë dhe objektit ekonomik.
- 3) Ali Cekaj
- ekzistimi i objektit ekonomik; rrënimi i shtëpisë dhe objektit ekonomik.

Dëshmitarët ekspert

Paditësit:

- 1) Eksperti i Gjeodezisë në Komunën e Deçanit, Muhamet Vishaj
- Eksperti i Gjeodezisë ka marrë pjesë në inspektimin e vendit të ngjarjes më 18 maj.
- 2) Eksperti i ndërtimtarisë në Komunën e Deçanit, Hyse Dinaj
- përcaktimit i vlerës së objektit në fjalë.

Vlerësimi faktik dhe ligjor

Hyrje

Nenet 154, 155 dhe 158 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (RFSJ 29/1978, më vonë LMD) ofron bazën ligjore për rastin. Sipas 154 paragrafi 1, kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij. Sipas nenit 155 edhe dëmi material dhe dëmi jo material, për shembull dhimbja psikike apo shkaktimi i frikës konsiderohen të jenë, “dëmtim apo humbje”. Sipas nenit 158 fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia.

Në këtë rast çështja kryesore qëndron a ka shkaktuar i padituri dëm apo humbje ndaj paditësve (nenet 154 -155 të LMD-së) me dashje ose nga pakujdesia duke i rrënuar atyre banesën dhe objektin ekonomik (neni 158). Paditësit së pari duhet të dëshmojnë që i padituri i ka rrënuar atyre banesën dhe objektin ekonomik.

Faktet e pamohueshme të këtij rasti janë theksuar në faqen 1. lidhur me çështjet faktike fillimisht duhet të zgjidhen pyetjet në vijim:

- A ekzistonte po ashtu edhe një objekt ekonomik në vendin në vendndodhjen në fjalë?
- A i ka rrënuar i padituri me dashje ose nga pakujdesia banesën dhe objektin ekonomik në fjalë?

Nëse vërtetohet që i padituri ka rrënuar këto objekte, gjithashtu edhe pyetjet në vijim duhet të zgjidhen:

- A është ky objekt në pronësi të paditësve?
- Cila është vlera e banesës dhe objektit ekonomik?
- A kanë pësuar paditësit dhembje dhe frikë (neni 155 i LMD-së)?

Ekzistimi i objektit ekonomik

Sipas paditësve ka ekzistuar gjithashtu edhe një objekt ekonomik afër banesës së të ndjerit Ilija Vukčević. Eksperti i Gjeodezisë në Komunën e Deçanit z. Muhamet Vishaj ka treguar nga një fotografi ajrore e marrë në vitin 1983 që afër objektit që përbehet nga dy banesa, ekzistonte po ashtu edhe një objekt tjetër.

Gjykata vëren se dëshmia e Muhamet Vishaj përputhët me dëshmitë e paditësve. Për më shumë, i padituri nuk ka pretenduar se do të kishte pasur edhe disa objekte tjera në këtë vendndodhje përveç këtyre dy objekteve që përmenden në padi. Prandaj është e natyrshme që objekti tjetër në këtë fotografi ajrore është pikërisht ky objekt ekonomik që ishte përmendur nga paditësit. Një tjetër çështje është, nëse ky objekt është në pronësi të paditësve apo nuk është.

Rrënimi i objekteve

Paditësit kana paraqitur disa prova me shkrim në lidhje me rrënimin e objekteve. Letra e inspektimit e datës 6.3.2007 (prova nr. 6) ishte shkruar nga z. Jashar Hulaj, Kryeinspektor në Komunën e Deçanit, i cili është dëgjuar gjithashtu si dëshmitar. Kjo letër i është adresuar Kryetarit të Komunës së Deçanit. Njoftimi i datës 7.3. dhe 7.5.2007 (prova nr. 7 dhe 8) të dyja ishin nga z. Haki Tahirukaj, drejtor i ndërmarrjes shoqërore NSH “Gjeravica”, e cila kishte qenë pronar i mëparshëm i banesës në fjalë. Të dy letrat u ishin drejtuar Zyrës Rajonale të AKM-së në Pejë. Gjykata vëren që në bazë të gjitha këtyre letrave “Manastiri i Deçanit” ka rrënuar këto objekte në fjalë. Jashar Hulaj ka shkruar një letër më datë 6.3.2007 (prova nr. 6) në bazë të asaj që ai kishte parë. Letrat e shkruar nga Haki Tahirukaj (prova nr. 7 dhe 8) që të dyja janë të bazuara nga letra prej Jashar Hulaj (prova 6). Prandaj të gjitha provat janë të bazuara në atë se çfarë kanë parë Jashar Hulaj bashkë me dy personat me të, Shkelzen Goqi dhe Ajne Iberhusaj, më 5.3.2007.

Dëshmitarët *Jashar Hulaj, Shkelzen Goqi dhe Ajne Iberhusaj* të gjithë dëshmojnë se ata kanë parë kur ka ndodhur rrënimi i këtyre objekteve më 5 mars 2007. Ata të gjithë ishin duke punuar për Komunën e Deçanit dhe ata kishin qenë duke e bërë inspektimin e tyre të rregullt të ndërtimit. Të gjithë këta dëshmitar okular kanë dëshmuar që ata kanë parë një person me mantel të zi dhe me mjekër duke drejtuar ekskavatorin dhe duke rrënuar objektet në vendndodhjen në fjalë. Ata po ashtu kanë parë disa persona tjerë me rroba “civile” në vendndodhje. Ata nuk kanë identifikuar asnjë person në vendndodhje, por nga rrethanat dhe veshja e këtij personi që voziste ekskavatorin ata të gjithë përfunduan që personat që ata i kishin parë në vendndodhje ishin nga Manastiri. Ata po i shikonin ngjarjet nga një veturë në lëvizje nga një distancë prej 20 - 25 metra. Ata nuk ishin lejuar që të ndalen sepse kjo kishte ndodhur në zonën e Manastirit, e cila ruhej nga KFOR-i.

Gjykata gjen se nuk ka asnjë arsye që të vihet në dyshim besueshmëria e dëshmitareve të sipërpërmendur dhe observimeve të tyre. Prandaj, edhe duke marrë parasysh po ashtu që kjo vendndodhje gjendet në zonën e manastirit dhe është dhe po ashtu ka qenë më 5.3.2007 –e ruajtur nga KFOR-i, është e qartë se personat nga manastiri i kanë rrënuar këto objekte. Vetëm personat nga Manastiri e kishin të mundur qasjen në këtë vendndodhje. Në bazë të këtyre arsyeve gjykata konstaton se është dëshmuar se disa persona nga Manastiri i Deçanit kanë rrënuar objektet në fjalë. Megjithatë, nuk ka asnjë dëshmi që sugjeron që i padituri do të kishte qenë përgjegjës rreth kësaj. Asnjëri nga dëshmitarët okular nuk e kanë identifikuar të pandehurin të ketë qenë njëri nga personat në vendndodhje.

Përfundimet

Gjykata gjen se sipas padisë “*i padituri i ka rrënuar*” këto objekte. Në mënyrë që të vërtetohet ky argument, paditësit duhet ta vërtetojnë ose që vetë i padituri fizikisht i ka rrënuar objektet apo të paktën që ai ka dhen urdhra për atë. Paditësit nuk e kanë bërë

këtë— ata vetëm kanë dëshmuar se disa persona nga manastiri e kanë bërë këtë. Fakti që i padituri është peshkopi i Manastirit të Deçanit nuk vërteton që ai ka dhënë urdhra për ti rrënuar këto objekte. Disa persona tjerë nga manastiri apo kisha katolike mund të kenë dhënë urdhrin apo dikush nga manastiri mund të ketë rrënuar këto objekte krye në vete, pa kurrfarë urdhri.

Mbi këto baza, gjykata konstaton së paditësit nuk kanë vërtetuar që i padituri ka rrënuar këto objekte. Padia duhet të refuzohet. Prandaj nuk është e nevojshme që të zgjidhen çështjet tjera që janë në kontest: a ka qenë objekti ekonomik në pronësi të paditësve, vlera e këtyre objekteve dhe a ju është shkaktuar paditësve dhembje dhe frikë.

Shpenzimet e procedurës gjyqësore

Sipas nenit 452 paragrafi 1 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqituese, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t'ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore. Sipas nenit 453 paragrafi 1 me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t'i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat. Sipas paragrafit 2 po që se është parashikuar tarifa për shpërblimin e avokatëve, apo për shpenzimet tjera, atëherë këto shpenzime do të matën sipas tarifës së tillë.

Pasi që paditësit e kanë humbur rastin, ata obligohen ti kompensojnë së bashku të paditurit shpenzimet e procedurës gjyqësore. Avokati i të paditurit ka siguruar gjykatën me një sqarim të shpenzimeve gjyqësore dhe ka kërkuar një shumë totale prej 1.550,18 euro.

Gjykata gjen se tarifat e Odes së Avokateve të Kosovës, të cilat janë të bazuara mbi Ligjin mbi Avokatinë (03/L-117). Sipas këtyre tarifave, tarifa bazë për një seancë është 101,40 euro dhe 18 Euros për çdo orë shtesë. Sipas procesverbaleve, seancat e mëposhtme janë mbajtur dhe shpenzimet për secilën seancë janë si në vijim:

- Seanca e EULEX-it për të marrë përsipër rastin më 4.11.2010, 35 minuta=> 101,40 euro;
- Seanca paraprake më 23.3.2011, 5 orë (pauza e drekës nuk përfshihet) => 173,40 euro;
- Seanca paraprake më 12.4.2011, 4 orë => 155,40 euro;
- Seanca paraprake më 18.5.2011, 5 orë (pauza e drekës nuk përfshihet) => 173,40 euro;
- Seanca paraprake më 19.5.2011, 3 orë => 137,40 euro;
- Seanca paraprake më 26.5.2011, 3 orë => 137,40 euro.

Përveç kësaj, avokati i të pandehurit ka të drejtën e kompensimit prej 78 eurove edhe për përgjigjen me shkrim mbi padinë dhe parashitësën me shkrim të datës 8.4.2011, siç ai ka kërkuar. Për më tepër, ai ka të drejtë për kompensim duke munguar në zyrë. Sipas tarifave ky kompensim është 25,35 euro për ditë, në total 152,10 euro, siç ka kërkuar ai. Gjykata

ka refuzuar kërkesën për 55,70 euro për rishqyrtimin e shkresave të lendes, sepse rasti ka qenë mjaft i lehtë për avokatin e të paditurit dhe është e paqartë se në çfarë është bazuar kjo kërkesë. Gjykata ka llogaritur shumën e shpenzimeve të nevojshme bazuar në këto informata dhe ka ardhur tek përfundimi, se shuma e duhur është 1.186,50 euro në total.

KËSHILLË JURIDIKE

Palët mund të paraqesin ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Qarkut në Pejë, përmes Gjykatës Komonale në Deçan brenda pesëmbëdhjete (15) ditëve nga dita kur pala ka pranuar një kopje të aktgjykimit.

Gjykata Komonale në Deçan, 10 Qershor 2011

Riku Jaakkola

Kryetar i Trupit Gjyqësor

Gjyqtar i EULEX-it

Përkthyer nga: E. ZENUNAL EULEX IJ06L

